



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRIM TË QYTETIT CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA			
Sh.	01	Nr.	10793
U.		Br.	
Nr. i faq.	09	Data:	05/05/
Br. str.		Datum:	05/05/
KAMENICË/A		Komuna e Kamenicës	
		Opstina Kamenica	
		Kamenica Municipality	



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më: 02.05.2025

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, nenit 17 dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a) të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/2008), dhe të nenit 38, paragrafi 38.2, pika a) i Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë:30.04.2025 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR THEMELIMIN DHE PUNEN E ASAMBLESE KOMUNALE TË FËMIJËVE NE KOMUNEN E KAMENICES

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Qëllimi i Rregullores

Qëllimi i themelimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve është edukimi i fëmijëve për proceset vendimmarrëse dhe avancimit të të drejtave të tyre. Kjo asamble u mundëson fëmijëve të shprehin mendimet, shqetësimet dhe propozimet në lidhje me çështjet që ndikojnë në jetën e tyre shkollore. Ajo ndihmon gjithashtu në zhvillimin e aftësive të fëmijëve për të qenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, duke i angazhuar ata në aktivitete që promovojnë drejtësinë, barazinë dhe mirëqenien e fëmijëve.

Neni 2

Qëllimi i Asamblesë

- 2.1. Pjesëmarrja aktive në zhvillimin dhe realizimin e veprimeve në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, punës humanitare dhe aktiviteteve të tjera me interes për fëmijët dhe komunitetin;
- 2.2. Zhvillimi i bashkëpunimit me Këshillat Drejtues të Shkollave, Këshillat e Prindërve, Këshillat e nxënësve dhe komunitetin lokal;

- 2.3. Krijimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me mekanizmat dhe organizatat tjera;
- 2.4. Ngritja e vetëdijes për të drejtat e fëmijës, përgjegjësitë dhe gjithë përfshirja e interesave të fëmijëve/nxënësve;
- 2.5. Avokimi mbi çështje të ngritura nga vetë fëmijët;
- 2.6. Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete të identifikuar nga vetë fëmijët, dhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve;
- 2.7. Inkurajimi i tolerancës, solidaritetit dhe demokratizimi;
- 2.8. Promovimi i vlerave shoqërore.

Neni 3

Kompetencat

Obligimet dhe detyrat e Asamblesë:

- 3.1. Të parashtrorjnë kërkesa, të japin mendime dhe sugjerime për institucionet relevante komunale, për Këshillat e Shkollës, Këshillat e Prindërve dhe drejtoritë lidhur me zbatimin e rregulloreve të sjelljes në shkollë, planin zhvillimor të shkollës, aktivitetet e lira, pjesëmarrjen në aktivitete kulturore-artistike, konkurse të ndryshme dhe organizimin e të gjitha manifestimeve të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj në interes të fëmijëve;
- 3.2. Të kërkojnë avansimin e bashkëpunimit të nxënësve dhe mësuesve, edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional;
- 3.3. Të informohen rreth çështjeve me rëndësi të veçantë për jetën e tyre shkollore ;

Neni 4

Organizimi i Asamblesë

Organizimi i Asamblesë komunale të Fëmijëve – Asamblesë në Komunën e Kamenicës rregullohet si vijon:

- 4.1. Të gjitha Shkollat e Mesme të Ulëta, më tutje SHMU, të delegohen përfaqësuesit e zgjedhur për Asamblienë Komunale të Fëmijëve. Të gjitha shkollat përfaqësohen me nga dy nxënës.
- 4.2. Organet e Asamblesë janë: Kryetar-ja/i, kryesia e përbërë nga 3 anëtarë.
- 4.3. Asambleja formon komisione sipas nevojës të për zgjedhur nga vetë asambleistët;
- 4.4. Përfaqësuesit e deleguar në Asamble zgjidhen në SHMU përmes procesit zgjedhor në fillim të vitit shkollor dhe përfshin nxënësit e klasave gjashtë-nëntë (6-9);
- 4.5. Zyrtari për të drejta të fëmijëve nga NJKDNJ në nivel komunal organizon zgjedhjet për Asamble në koordinim me DKA;

- 4.6. Njësia komunale për të drejta të njeriut (NJKDNJ) e ndihmon, monitoron dhe raporton për punën e Asamblesë;

Neni 5

Vendimet e Asamblesë

Asambleja merr vendime për arritjen e qëllimeve të përcaktuara dhe miraton:

- 5.1. Planin vjetor të punës së Asamblesë;
- 5.2. Rregulloret e brendshme si dhe ndryshimet në rregullore;
- 5.3. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Asamblesë;
- 5.4. Shqyrton dhe miraton së paku një raport vjetor të punës së Kryesisë dhe komisioneve;
- 5.5. Shqyrton dhe miraton propozimet e anëtarëve të Asamblesë dhe komisioneve.

Neni 6

Mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve për Asamblëtë

- 6.1. Në takim të përbashkët, këshilli i nxënësve fton kryesitë e klasave nga 6-9;
- 6.2. Nga të gjithë nxënësit e ftuar në takim përzgjidhen përfaqësuesit për asamblenë me votim të fshehtë, sipas Nenit 4, par.4.4, të kësaj Rregulloreje;
- 6.3. Secili nxënës prezent në takim ka të drejtë të propozojë dhe të jetë i propozuar;
- 6.4. Secili nxënës ka të drejtë të deklarohet se a pajtohet të jetë kandidatë përfaqësues i shkollës për Asamble;
- 6.5. Nxënësit e kandiduar për përfaqësues të shkollës në Asamble mund të paraqiten me një fjalë rasti;
- 6.6. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes procesit të votimit të mbyllur;
- 6.7. Përzgjedhja e Asambleistëve bëhet në javën e tretë të Shtatorit;
- 6.8. Duke respektuar gjithëpërfshirjen, përzgjidhen kandidatët të cilët kanë numrin më të madh të votave;
- 6.9. Nxënësi dhe nxënësja që ka numër më të madh të votave, përzgjidhet përfaqësues i shkollës në Asamblenë komunale.

Neni 7

Mbledhjet e Asamblesë

- 7.1. Katër mbledhje të Asamblesë janë obligative gjatë një viti kalendarik, ndërsa nëse është e nevojshme edhe më shpesh, me propozim të Kryetarit, Kryesisë, DKA-së si dhe me iniciativën e një të tretës të anëtarëve të Asamblesë;

- 7.2. Asambleja vendos me shumicën e votave të anëtarëve prezent;
- 7.3. Anëtarët informohen përmes postës elektronike dhe formave tjera për pikat e rendit të ditës, kushtet e seancës si dhe informata shtesë;
- 7.4. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjeve është gjysma, plus një (shumica e thjeshtë).

Neni 8

Përgjegjësitë anëtarëve të Asamblesë

- 8.1. Anëtarët e Asamblesë kanë mandat derisa janë duke ndjekur mësimin në SHMU
- 8.2. Mandati i anëtarëve të Asamblesë përfundon me dorëheqje, pas përfundimit të mandatit ose mungesës pa arsye në tri seanca radhazi
- 8.3. Asambleja raporton me shkrim tek NJKDNJ
- 8.4. Secili anëtar i Asamblesë njofton Këshillin e Nxënësve të shkollës që e përfaqëson për punën e Asamblesë

Neni 9

Të drejtat e anëtarëve të Asamblesë

Anëtar i Asamblesë ka të drejtë:

- 9.1. Të marr pjesë në takimet e Asamblesë në kushte të barabarta me anëtarët e tjerë;
- 9.2. Të propozon pikat për diskutim, veprimet, dhe dokumentet e tjera për shqyrtim
- 9.3. Të marr pjesë në realizimin e të gjitha aktiviteteve të asamblesë;
- 9.4. Të informohet në kohën e duhur për punën dhe aktivitetet e Asamblesë;
- 9.5. Të shprehet lirshëm;
- 9.6. Të kërkojë dhe të marrë informata nga Kryesia për çështje të rëndësishme në lidhje me ushtrimin e funksionit të asamblistit të ri;
- 9.7. Të kërkojë dhe marr informata nga DKA për çështjet që kanë të bëjnë me punën e tyre
- 9.8. Të ketë vetëm një propozim për një çështje të caktuar;
- 9.9. Të shfrytëzojnë ambientet e Asamblesë që u janë dhënë në dispozicion për punë dhe takime, në bashkëpunim me Komunën/Kuvendin Komunal.

Neni 10

Detyrat e anëtarëve të Asamblesë

Anëtarët e Asamblesë janë të detyruar:

- 10.1. Të kontribuojë në mënyrë aktive në arritjen e objektivave;

- 10.2. Të marr pjesë në përputhje me interesat e zgjedhësve në aktivitetet e Asamblesë;
- 10.3. Ta respektojnë njëri-tjetrin;
- 10.4. Të kryen detyra të tjera që i janë besuar atij/asaj nga Asambleja;
- 10.5. Ti përgjigjet ftesës së Kryetarit/es së Asamblesë lidhur me punë e Asamblesë;
- 10.6. Të nënshkruhen në fillim dhe mbarim të seancës për praninë e tyre;
- 10.7. Me shumicë votash ta aprovojnë, ndryshojnë apo plotësojnë rendin e ditës të propozuar nga Kryetari;
- 10.8. Të votojnë me shumicë votash propozimin e arsyetuar për shtyrjen apo tërheqjen e pikave të caktuara të rendit të ditës.

Neni 11

Mënyrat e votimit

- 11.1. Votimet mund ti bëjë me vota të hapura ose të mbyllura. Këtë e vendosin asamblistët;
 - a) Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa
 - b) Votimi i mbyllur(fshehtë) bëhet me fletëvotime. Votimin e fshehtë e udhëheqë dhe monitoron Komisioni i votimit;
- 11.2. Para se të fillohet me votim të fshehtë, Asambleja propozon dhe zgjedhë tre (3) anëtarë të Komisionit për numërimin e votave;
- 11.3. Konsiderohet i pavlefshëm fletëvotimi prej të cilit nuk mund të konstatohet me saktësi se si ka votuar asambleisti;
- 11.4. Pjesëmarrësit në votim, kanë vetëm një (1) herë të drejtë të votojnë;
- 11.5. Seancat janë të hapura dhe publike.

Neni 12

Zgjedhja e Kryetarit/es dhe Kryesisë së Asamblesë

- 12.1. Asambleja zgjedh një (1) Kryetar/e, një (1) Nënkyetar/e, një (1) Sekretar/e;
- 12.2. Nënkyetari propozohet dhe zgjidhet nga anëtarët e asamblesë duke votuar;
- 12.3. Sekretari propozohet nga kryetari i asamblesë dhe votohen nga Asambleja;
- 12.4. Zgjedhja e Kryetarit/es bëhet me vota të hapura ose të mbyllura (shih Neni 11);
- 12.5. Kryetari/ja i/e sapo zgjedhur pas fjalimit të tij/saj rreth objektivave përgjatë punës menjëherë hapë votimin për përzgjedhjen e Kryesisë (Nënkyetarëve, sekretarit/es).

Neni 13

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e kryetar-it/es së asamblesë

- 13.1. Kryetar-i/ja ka mandat të plotë 2 vjeçar nga momenti i zgjedhjes së tij/saj;

- 13.2. Kryetar-i/ja mund të bëjë propozime dhe ka të drejtë vote, dhe në rast të votimit të barabartë vota e Kryetar-it/ës është një votë më shumë;
- 13.3. Ka të drejtë të ndërpresë seancën nëse ka parregullsi;
- 13.4. Ka të drejtë ta largojë asambleist-in/en nga salla nëse ka shkelur Kodin e Mirësjelljes;¹
- 13.5. Kujdeset për zbatimin e Rregullores së Punës dhe për përmirësimin e kushteve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve;
- 13.6. Kryetari/ja duhet ta thërret mbledhjen së paku katër herë në vit, apo sipas nevojës;
- 13.7. Kryetari/ja nuk duhet të mungojë në tre (3) mbledhje radhazi, po qe se ai/ajo mungon pa arsye, atëherë mund të kërkohet edhe shkarkimi i tij/saj;
- 13.8. Kryetari/ja nuk ka të drejtë të bëjë anime (ndarje);
- 13.9. Nëse Kryetari/ja mungon, vazhdon seanca me Nënkryetarin/en;
- 13.10. Nëse mungon edhe Nënkryetari/ja, atëherë vazhdon me sekretarin. Nëse Kryetari/ja bën shkelje të Rregullores së Punës dhe Kodit të Mirësjelljes, ai/ajo mund të shkarkohet me votimin e 2/3 të Asambleistëve.

Neni 14

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nënkryetarit

- 14.1. Asambleja duhet të ketë 1 Nënkryetar;
- 14.2. Nënkryetar-i/ja i Asamblesë i ndihmon Kryetarit/es në kryerjen e punëve dhe kryen punë të tjera nga fushëveprimet e tij/saj;
- 14.3. Me autorizimin e Kryetarit, mund ta zëvendësoj atë brenda dhe jashtë vendit, varësisht nga agjenda e takimit.

Neni 15

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit/es

- 15.1. Sekretari/ja i/e Asamblesë është pjesë e Kryesisë dhe ka detyrat e përcaktuara;
- 15.2. Sekretari/ja me kërkesë të Kryetarit thirr seancën, cakton datën, orën dhe vendin e mbajtjes së seancës dhe mban procesverbalin;
- 15.3. Ruan dokumentet e Asamblesë, dhe e bën evidentimin e prezencës të asamblistëve;
- 15.4. Sekretari ka përgjegjësi të monitorojë implementimin e planit të veprimit të Asamblesë.

Neni 16

Detyrat dhe të drejtat e Kryesisë së Asamblesë

- 16.1. Kryesia e Asamblesë zgjidhet nga vet asamblastët dhe duhet të jetë e përbërë nga tre (3) anëtarë
- 16.2. Anëtari/ja i/e Kryesisë nuk mund të ketë më shumë se një post
- 16.3. Mbajnë shënime dhe shfaqin idetë e tyre për të mirën e fëmijëve.
- 16.4. Cakton rendin e ditës në bashkëpunim me anëtarët e Kryesisë, (nënkryetarin, sekretarin, arkëtarin në krye me Kryetarin/en)
- 16.5. Harton plan programin dhe kalendarin e punës
- 16.6. Vendimet e Kryesisë miratohen nga asamblastët.

Neni 17

Procesverbali

- 19.1. Për punimet e seancës së Asamblesë Komunale të Fëmijëve mbahet procesverbali (shih Neni 15);
- 19.2. Procesverbali i përmban të dhënat kryesore për punimet e seancës, propozimet e paraqitura dhe konkluzionet e miratuara në lidhje me çështjet e rendit të ditës;
- 19.3. Procesverbali sipas rregullit, i shpërndalet nëpërmes postës elektronike dhe mënyrave tjera të gjithë asambleistëve më së voni një (1) ditë para seancës që do të miratohet;
- 19.4. Sekretari/ja i/e Asamblesë ka për detyrë përgatitjen dhe ruajtjen e procesverbaleve origjinale të seancave të Asamblesë.

Neni 18

Publikimi dhe njoftimi

- 20.1. Puna e Asamblesë është publike, ku të gjitha procesverbalet, planet e veprimit, minutat e takimeve, publikimet, dhe çfarëdo e dalur nga asambltetë, publikohen në uebfaqen e Asamblesë dhe mbikqyret nga NJKDNJ;
- 20.2. Kryesia kujdeset për informimin e rregullt të anëtarëve dhe publikut për punën dhe aktivitetet e Asamblesë, qoftë drejtpërdrejt, komisionit për informim ose përmes publikimit të aktiviteteve.

Neni 19

Bashkëpunimi

- 21.1. Për të arritur qëllimet, Asambleja krijon kontakte dhe bashkëpunon me shoqatat dhe organizatat e tjera profesionale, shkencore, arsimore dhe të ngjashme;
- 21.2. Lidhur me 21.2 si më lart, Asambleja bashkëpunon dhe koordinohet me Komunën/Kuvendin Komunal.

Neni 20

Mjetet dhe financimi

- 22.1. Mjetet e nevojshme për funksionimin dhe financimin e aktiviteteve realizohen përmes: planifikimit buxhetor komunal dhe qeveritar (buxhetimit miqësor për fëmijë), mbledhjes së fondeve, shkollat, kontributet vullnetare të nxënësve, mësuesve, prindërve dhe donacionet nga organizatat e biznesit, si dhe donatorë të tjerë.

Neni 21

Modifikimi i Rregullores

- 23.1. Ndryshimet në Rregullore janë të mundshme në bazë të propozimit të një të tretës së anëtarëve të Asamblesë.

Neni 22

Pushimi i punës së Asamblesë

- 24.1. Asambleja pushon së punuari me vendimin e shumicës së anëtarëve, kur pushojnë kushtet për arritjen e objektivave.

Neni 23

Dispozitat përfundimtare

- 25.1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Njësia komunale për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria Komunale e Arsimit, si dhe Drejtoritë tjera komunale.

Neni 24

Hyrja në fuqi

26.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

**Liridon Kastrati**

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA KOSOVA	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETIT	
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. U.	Nr. Br.
01	10794
Nr. i fag. Br. Str.	Data: Datum:
02	25/05/2025
KAMENICE/A	

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më: 02.05.2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), kërkesës Sh.02.Nr.6681 të datës 20.03.2025, e parashtruar nga z. Albert Thaqi Kryetar në Këshillin Lokal të fshatit Muçivërc, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja h), nenit 38, paragrafi 38.1, të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë:30.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc

1. Miratohet vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e një objekti shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, në bazë të kërkesës së parashtruar nga Këshilli Lokal i fshatit Muçivërc, me nr. protokolli Sh.02.Nr.6681 të datës 20.03.2025.
2. Lokacioni nga pika 1 e këtij vendimi, është parcela me numër të ngastrës kadastrale P-71107055-00707-1, me sipërfaqe prej 25163 m², pronë e Kuvendit Komunal të Komunës së Kamenicës, në zonën kadastrale Muçivërc.
3. Qëllimi i caktimit të këtij lokacioni është ndërtimi i një objekti shumëfunksional nga ana e Këshillit Lokal në fshatin Muçivërc, i cili do t'i shërbejë komunitetit lokal për nevoja të ndryshme, përfshirë organizime festive, mortore, si dhe aktivitete të tjera me karakter shoqëror dhe kulturor.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë Kërkesa Sh.02.Nr.6681 të datës 20.03.2025, e parashtruar nga Kryetari i Këshillit Lokal të fshatit Muçivërc, Kopja e Planit të datës 20.03.2025 dhe Certifikata me numër të lëndës 645/2025 e datës 20.03.2025.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

A r s y e t i m

Këshilli Lokal i fshatit Muçivërc ka paraqitur kërkesën Sh.02.Nr.6681 më datë 20.03.2025 në Komunë për dhënien në shfrytëzim të një parcele të pronës komunale me qëllim të ndërtimit të një objekti shumëfunksional, i cili do të shërbejë për nevojat e komunitetit lokal. Sipas kërkesës së paraqitur dhe vlerësimit të bërë, është konstatuar se në fshatin Muçivërc mungon një objekt i tillë që do t'u shërbente banorëve për organizime me karakter festiv, mortor, si dhe për aktivitete të tjera shoqërore e kulturore.

Objekti i planifikuar për ndërtim nga ana e Këshillit Lokal do të ketë funksion publik dhe do të jetë në shërbim të banorëve të fshatit, pa ndonjë qëllim fitimprurës. Gjithashtu, parcela e propozuar për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, ndodhet brenda zonës së planifikuar për zhvillim të infrastrukturës lokale, prandaj konsiderohet e përshtatshme për realizimin e këtij projekti.

Caktimi i Lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional për Këshillin Lokal është në përputhje me qëllimet e Komunës për mbështetjen e zhvillimit të jetës komunitare dhe përmirësimin e kushteve për organizim dhe bashkëpunim në nivel lokal.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor, MAPL-së, QSHQ-Arkivit.



Irindon Kastrati

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS / OPŠTINA KAMENICA



FORMULARI PËR KËRKESË OSE ANKESË / OBRAZAC ZAHTEVA ILI ŽALBE

PËR: DREJTORINË / NJËSINË:
ZA: ODELENJE / JEDINICU:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PËR SHËRBYM TË Q.
CENTAR ZA USLUGU GRAHANA

Sh. 02 Nr. 6681
U. Br.
Nr. i faq. 5 Data: 20/03
Br. str. Datum: 2025
KAMENICA

ZYREN E KRYETARIT

Informatat personale të parashtruesit të kërkesës / Lični podaci podnosioca zahteva ili žalbe:

Emri dhe Mbiemri / Ime i Prezime

ALBERT THAQI

Vendbanimi / Prebivalište

MUÇIVERC

Numri Personal / Matični broj

1011707919

Numri i telefonit / Broj telefona

044-321-577

e-mail adresa

Albertthaqi@shqiptar.eu

Kërkesë / Zahtev

☒

Ankesë / Žalba

☐

Ju lutem shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje / Molimo Vas da detaljno napišete Vaš zahtev ili žalbu

Me këtë kërkesë i drejtohem Kryetarit të Komunes.
2. Kadri Rahimaj që të na ndihmoj me një projekt
që e kemi nisur në fshatin Muçiverc.
Projekti ka të bëjë me një objekt i cili është i nevojshëm
në fshatin Muçiverc i cili do të na shërbejë për nevojat
e fshatit, për aktivitetet të fshatit, shkollës, për dasma
në rastë vdekje etj.
Për kërkojmë nga ju që të na jepni në shfrytëzim
për periudhë kohore prej 15 vitesh parcelën me numër
707-1, në fshatin Muçiverc.
Të bashkëpunojtur kemi edhe planin ideor.


DATA:

DATUM: 20.03.2025

Nënshkrimi:

Potpis:

Ataqi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
CENTRA PËR SHËRIM TË GJATË
CENTAR ZA USLUGU GRAMATA

Sh. Nr. 01/6648
U. Br. 6648
Nr. i faq. 4 Data: 20/03
Br. str. 2025
KAMENICE A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi

REFERENC-Ë:	SH.Z nr_02-07-053-2025
PER/ZA/TO:	Liridon Kastrati Kryesues i Kuvendit
CC:	Kryetari Komunes Kadri Rahimi
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtoris për KGJP-si - Diana Apvazi
NGA/OD/FROM:	PKGJD-si z/- shef Fadil Hoti
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Përgjigjeje
Nr. i Zyrës:	
Br. Kancelarije:	
Room No:	
Lokacioni:	
Lokacija:	
Extencion:	
Objekti i Komunes	20.03.2025
Për aktivitet/Za aktivnost/For action.	
Per miratim/Za usvajanje/For aprova	
Per nënshkrim/Za potpis/ For signature.	
Per komente/Za komentare/For comments.	
A mund të diskutojmë/Dali možemo raspravljati/ May we discuss.	
Vëmendja e juaj/ Vaša pažnja/Your attention.	
Sipas diskutimit/Kako je raspravljeno/ As discussed.	
Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/ As requested.	X
Shënim dhe përgjigje/ Beleska i odgovor/ Note and retur.	X
Për informimin tuaj/ Za vasu informaciju/ For your information.	
Afati/ Rok/Deadline/.	

Indernat

Drejtoria për KGJP-si ka pranuar kërkesë nga Zyra e Kuvendit Komunal me Sh09 me Nr. 6609 faqe 01 te datës 20.03.2025 ka shqyrtuar dhe jep këtë përgjigjeje pasi kemi kontrolluar sistemin ne sektorin e Kadastërit Parcela e kërkuara është parcelë ne pronësi Komuna E Kamenicës P-71107055-00707-1 sipërfa 25163m2 Dokumentit ja bashkëngjisim Fletën Poseduese me nr ref 645/2025 te datës 20.03.2025 e punuar nga z. V Dalipi dhe kopjen e planit te punuar nga Gjeodeti R. Ismajli.

Me respekt DPGJK



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Življne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71107055-00707-1

Numbri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 645/2025
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 20.03.2025 - 14:15
Komuna / Opština / Municipality: KAMENICË / KAMENICA / KAMENICE
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Muçiverc / Muçiverc / Muçiverc
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KAMENICË / KAMENICA / KAMENICE

L. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numbri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71107055-00707-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		25163	3-2003		

K.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
MUJIN POTOK				

A.2. LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Brez Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Supërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujëqesori/Pojoprvredna/Agriculture	Kullasë/Pashnjak/Pasture	Kullasë E Klasës 3/Pashnjak 3 Klasse/3rd Class Pasture	25163

3. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postat Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
osoba/individual / individualna Društva / single possessor	Komuna e Kamenicës	600535390	/ / /		SKENDERBEU	1/1		20.01.2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA KOSOVA	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETIT	
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. U.	Nr. Br.
01	10794
Nr. i fag. Br. Str.	Data: Datum:
02	25/05/2025
KAMENICE/A	

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më: 02.05.2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), kërkesës Sh.02.Nr.6681 të datës 20.03.2025, e parashtruar nga z. Albert Thaqi Kryetar në Këshillin Lokal të fshatit Muçivërc, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja h), nenit 38, paragrafi 38.1, të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë:30.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc

1. Miratohet vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e një objekti shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, në bazë të kërkesës së parashtruar nga Këshilli Lokal i fshatit Muçivërc, me nr. protokolli Sh.02.Nr.6681 të datës 20.03.2025.
2. Lokacioni nga pika 1 e këtij vendimi, është parcela me numër të ngastrës kadastrale P-71107055-00707-1, me sipërfaqe prej 25163 m², pronë e Kuvendit Komunal të Komunës së Kamenicës, në zonën kadastrale Muçivërc.
3. Qëllimi i caktimit të këtij lokacioni është ndërtimi i një objekti shumëfunksional nga ana e Këshillit Lokal në fshatin Muçivërc, i cili do t'i shërbejë komunitetit lokal për nevoja të ndryshme, përfshirë organizime festive, mortore, si dhe aktivitete të tjera me karakter shoqëror dhe kulturor.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë Kërkesa Sh.02.Nr.6681 të datës 20.03.2025, e parashtruar nga Kryetari i Këshillit Lokal të fshatit Muçivërc, Kopja e Planit të datës 20.03.2025 dhe Certifikata me numër të lëndës 645/2025 e datës 20.03.2025.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

A r s y e t i m

Këshilli Lokal i fshatit Muçivërc ka paraqitur kërkesën Sh.02.Nr.6681 më datë 20.03.2025 në Komunë për dhënien në shfrytëzim të një parcele të pronës komunale me qëllim të ndërtimit të një objekti shumëfunksional, i cili do të shërbejë për nevojat e komunitetit lokal. Sipas kërkesës së paraqitur dhe vlerësimit të bërë, është konstatuar se në fshatin Muçivërc mungon një objekt i tillë që do t'u shërbente banorëve për organizime me karakter festiv, mortor, si dhe për aktivitete të tjera shoqërore e kulturore.

Objekti i planifikuar për ndërtim nga ana e Këshillit Lokal do të ketë funksion publik dhe do të jetë në shërbim të banorëve të fshatit, pa ndonjë qëllim fitimprurës. Gjithashtu, parcela e propozuar për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, ndodhet brenda zonës së planifikuar për zhvillim të infrastrukturës lokale, prandaj konsiderohet e përshtatshme për realizimin e këtij projekti.

Caktimi i Lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional për Këshillin Lokal është në përputhje me qëllimet e Komunës për mbështetjen e zhvillimit të jetës komunitare dhe përmirësimin e kushteve për organizim dhe bashkëpunim në nivel lokal.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor, MAPL-së, QSHQ-Arkivit.



Irindon Kastrati

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më: 05.05.2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 paragrafi 2 shkronja d) nenit 17 dhe 24 paragrafit 24.1 dhe 24.2, neni 40 paragrafit 40.2, shkronja b) dhe c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), neni 30 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 9 Ndarjet Buxhetore komunale pika 6 (Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 Nr 08/L-332, neni 2, neni 7 dhe neni 8 të Ligjit Nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, kërkesa Sh.02.Nr.9666 e datës 24.04.2025 të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit për bartjen e të hyrave vetanake të tejkaluara 2024 në 2025, neni 38, paragrafi 38.1, Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë:30.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E MJETEVE NGA TË HYRAT VETANAKE TË BARTURA NGA VITI 2024 NË VITIN 2025

1. Me këtë akt miratohet bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2024 në vitin 2025 në shumën totale prej **408,555.27 €**.
2. Mjetet buxhetore për bartje si në pikën (1) një të këtij vendimi do të shpërndahen: si në vijim

2.1 Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe shërbime ne shume prej 31,701.95€ si vijon:

Infrastruktura Publike (18189), kodi funksional (0451) shuma prej 31,701.95 €

2.2 Në kategorinë e shpenzimeve shpenzimet kapitale në shume prej 376,853.32 € në projektet si në vijim :

Zyra e kryetarit (16029), kodi funksional (0111), shuma prej 64,000.00€

"Participimi me Donator" Kodi i projektit 52633 shuma prej **64,000.00€**

2.3 Planifikimi Mjedisor dhe Inspekcioni (66650), kodi funksional (0620) shuma prej 139,417.32€

2.4. Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Bosavate (Rr Tema ,Rama) kodi i projektit 56380 shuma prej 9,694.95€

2.5 Asfaltimi i rrugëve ne Hogosht (Nexhmedin Ahmeti Xhaqku, Degz Rexhep Mala, Shefik Latifi, Ali Myrtaj, Degz Martiret e Hogoshtit, Isa Kastrati, Avdi Xhaqku”, kod i projektit 56381 shuma prej 78,893.82 €.

2.6 Asfaltimi i rrugëve ne Berivojcë (Dardana ,Breznica)”, kod i projektit 56391,shuma prej 6,495.44 €.

2.7 Asfaltimi i rrugëve në Shipashnicë të Epërme (Raif Ismajli, Degz Pajazit Rama, Hasan Jashari,5 Shtatori, Sadri Misini, Degz Rexhep Baftiari, Bejtullah Ramadani , tj)”, kod i projektit 56394, shuma prej 44,333.11 €.

2.8 Planifikimi Urban dhe Inspekcioni (66450), kod funksional(0620) shuma prej 173,436.00 € si në vijim:

“Asfaltimi i rrugëve ne Koretin “,kod I projektit 54835,shuma prej 86,000.00€

“Asfaltimi i rrugëve ne Rogane” kod I projektit 54874,shuma prej 46,999.00

“Asfaltimi i rrugëve ne Hodonoc” kod I projektit 54877,shuma prej 40,437.00.

Arsyetim

- Sa i përket bartjes së të hyrave vetanake të mjeteve 2024 në kategorin e mallrave dhe shërbimeve nga fondi burimor 22, i cili është miratuar dhe është pjesë e nparagrafit 2.1 të këtij vendimi arsyetohet se:
Nën programi Infrastruktura Publike (18189) në shumë prej 31,701.95 fondi burimor 22, është ndarja buxhetore në nivel të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve për nën programin e lartë cekur nga te hyrat e bartura 2024 në shumë prej 31,701.95€ është si vijon:

Obligim i mbetur nga viti 2024 për punët e kryera nga OE EL-Bau SHPK për kontratën e nënshkruar “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e rrugëve te rendi të tretë” ku vlera e kontraktuar tre vjeçare është në shume prej 750,000.00€, /Shih Kontratën e datës 05.06.2024 me nr. 18482.

- Sa i përket Bartjes së të Hyrave Vetanake të mjeteve nga viti 2024 në kategorinë e shpenzimeve Kapitale nga fondi burimor 22, i cili është miratuar dhe është pjesë e paragrafit 2.2 të këtij vendimi dhe arsyetohet se :
Është obligim nga viti 2024 në bazë të kontratës me nr. 34568 date 30.10.2024 me nr. të kontratës KM653-24-8598-5-2-1/C642 për projektin ” Participimi me Donator-Ndërtimi i Lugut të verdhë –Ritenderim në shumë prej 192,562.20.Per vitin 2024 nga Kontrata janë ekzekutuar shuma prej 34,250.00€ dhe pjesa e mbetur e kontratës duhet te ekzekutohet nga shuma nga të hyrat e bartura 64,000.00€ dhe nga buxheti i vitit 2025 nga i njëjti kod i projektit /Të bashkangjitur kontrata me OE dhe pagesa e ekzekutuar ne vitin 2024 /

- Sa i përket Planifikimit Mjedisor dhe Inspektionit (66650), kodi funksional (0620) shuma prej 139,417.32€, nga fondi burimor 22, i cili është miratuar dhe është pjesë e nënparagrafit 2.3-2.4-2.5-2.6 dhe 2.7 të këtij vendimi arsyetohet se:

"Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bosavate (Rr Tema ,Rama)" kodi i projektit 56380 në shumë prej 9,694.95€. Ky është projekt i vitit 2024 "Asfaltimi i rrugëve lokale në Komunën e Kamenicës "Pjesa e ku janë të përfshira 8 fshatra me OE K.N.P.SH Papenburg&Adriani Company SH.P.K.Shuma e kontraktuar për asfaltimet e rrugëve në këtë fshat është 89,694.95€. Per vitin 2024 buxheti ka qene i ndare ne shume prej 50,000.00 dhe është rialoku në shumë prej 49,841.50€. Pagesa nuk ka pas për vitin 2024 për këtë OE dhe për vitin 2025 është planifikua një buxhet prej 80,000.00€.Pjesa e mbetur /9.694.95/ është planifikuar nga te hyrat e bartura .

"Asfaltimi i rrugëve në Hogosht (Nexhmedin Ahmeti, Xhaqku, Degz Rexhep Mala, Shefik Latifi, Ali Myrtaj, Degz Martiret e Hogoshtit, Isa Kastrati, Avdi Xhaqku)" kodi i projektit 56381 në shumë prej 78,893.82. Është projekt i vitit 2024 Asfaltimi i rrugëve lokale në Komunën e Kamenicës "Pjesa e II BI"VARNA SHPK ku janë të përfshira 8 fshatra, shuma e kontraktuar për këtë fshat është 228,893.82 €. Për vitin 2024 ka qenë buxheti i planifikuar në shumë prej 70,000.00. Nga kjo shumë është rialokuar shuma prej 69,175.40€.Pagesa nuk ka pas për vitin 2024 pos pagesa për hartim te projektit. Shuma e planifikuar për vitin 2025 sipas Ligjit te Buxheti 2025 për këtë projekt është 150,000.00€ dhe pjesa e mbetur nga kontrata duhet të financohen nga të hyrat e bartura /78,893.82€

Asfaltimi i rrugëve në Berivojce (Dardana, Breznica) kodi i projektit 56391 Në shumë prej 6,495.44€. Ky është projekt i vitit 2024 "Asfaltimi i rrugëve lokale në Komunën e Kamenicës "Pjesa e I-rë ku janë të përfshira 8 fshatra me OE K.N.P.SH Papenburg&Adriani Company SH.P.K Shuma e kontraktuar për asfaltimet e rrugëve në këtë fshat është 78,463.65€. Për vitin 2024 buxheti ka qene i ndarë në shumë pr ej 30,000.00. Pagesa nuk ka pas për vitin 2024 për këtë OE dhe për vitin 2025 është planifikua një buxhet prej 70,000.00€. Pjesa e mbetur është planifikuar nga te hyrat e bartura ne shume prej 6,495.44€.

Asfaltimi i rrugëve në Shipashnicë të Eperme (Raif Ismajli, Degz Pajazit Rama, Hasan Jashari, 5 Shtatori, Sadri Misini, Degz Rexhep Baftiari, Bejtullah Ramadani)kodi i projektit 56394, në shumë prej 44,333.11€. Është projekt i vitit 2024 Asfaltimi i rrugëve lokale në Komunën e Kamenicës "Pjesa e II BI"VARNA SHPK ku janë të përfshira 8 fshatra, shuma e kontraktuar për këtë fshat është 144,333.11€.Për vitin 2024 ka qenë buxheti i planifikuar në shumë prej 60,000.00. Nga kjo shumë është rialokuar shuma prej 59,242.50€. Pagesa nuk ka pas për vitin 2024 pos pagesa për hartim te projektit. Shuma e planifikuar për vitin 2025 sipas Ligjit te Buxheti 2025 për këtë projekt është 100,000.00€ dhe pjesa e mbetur nga kontrata duhet të financohen nga të hyrat e bartura /44,333.11€

- Sa i përket Planifikimit Urban dhe Inspektionit (66450), kodi funksional (0620) shuma prej 173,436.00 € nga fondi burimor 22, i cili është miratuar dhe është pjesë e nënparagrafit 2.8 të këtij vendimi arsyetohet se:

“Asfaltimi i rrugëve në Koretin” kodi i projektit 54835. Ky është projekt i vitit 2024 “Asfaltimi i rrugëve lokale në Komunën e Kamenicës “Pjesa e I-r ku janë të përfshira 8 fshatra me OE K.N.P.SH Papenburg&Adriani Company SH.P.K Shuma e kontraktuar për asfaltimet e rrugëve në këtë fshat është 233,828.96€. Për vitin 2024 buxheti ka qenë i ndarë në shumë prej 236,177.95. Pagesa për vitin 2024 është në shumë prej 92.079.04. Një pjesë e kontratës së mbetur është planifikuar nga të hyrat e bartura në shumë prej 86,000.00€.

Asfaltimi i rrugëve në Rogane, kodi i projektit 54874 në shumë prej 46,999.00€. Është projekt i vitit 2024 Asfaltimi i rrugëve lokale në Komunën e Kamenicës “Pjesa e II BI”VARNA SHPK ku janë të përfshira 8 fshatra, shuma e kontraktuar për këtë fshat është 145,680.98€.Për vitin 2024 ka qenë buxheti i planifikuar në shumë prej 99,113.91. Pagesa për vitin 2024 ka qene 99,107.32 dhe pjesa e mbetur nga kontrata duhet të financohen nga të hyrat e bartura /46,999.00€

Asfaltimi i rrugëve në Hodonoc kodi i projektit 54877 në shumë prej 40,437.00€. Është projekt i vitit 2024 Asfaltimi i rrugëve lokale në Komunën e Kamenicës “Pjesa e II BI”VARNA SHPK ku janë të përfshira 8 fshatra, shuma e kontraktuar për këtë fshat është 162,579.87€. Për vitin 2024 ka qene buxheti i planifikuar në shumë prej 122,616.53. Pagesa për vitin 2024 ka qene 122.142.53 dhe pjesa e mbetur nga kontrata duhet te financohen nga te hyrat e bartura /40,437.00€.

3. Pas miratimit të vendimit nga Kuvendi i Komunës, për zbatimin e tij, kujdeset Kryetari i Komunës.
4. Vendimit i bashkangjitetet: Kërkesa Sh.02.Nr.9666 e datës 24.04.2025 të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit për bartjen e të hyrave vetanake të tejkaluara 2024 në 2025.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit Profesional të Kuvendit, Zyrës për përkthime, Drejtorisë së Buxhet dhe Financa, MAPL-së dhe QSHQ - Arkivit.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Liridon KASTRATI



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PER SHERBIM TE QYTETAS CENTAR ZA USLUGU GRADANA	
Sh. 01	Nr. 10797
U. 01	Br. 10797
Nr. i faq. 01	Data: 25/05/2025
Br. str.	Datum: 2025
KAMENICE/A	

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 30.04.2025

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d), si dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 38 të Statutit të Komunës së Kamenicës Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 , Kuvendi i Komunës së Kamenicës, në seancën e mbajtur më 30.04.2025, miraton këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

Periudha 2025-2029


1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Kamenicës miraton Planin e veprimit për Transparencë 2025-2029.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i veprimit për mjedis 2025-2029, Sh.01 Nr. 9374.
3. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqe të komunës.
4. Përkujdesjen për zbatimin Planit të veprimit për mjedis 2025-2029, Komuna e Kamenicës

Vendimi iu dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencat Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, MAPL-së, QSHQ – Arkivit.


Liridon Kastrati
Kryesues i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më: 14.05.2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 paragrafi 12.2 shkronja d) neni 24 paragrafi 1 dhe 2, si dhe neni 40 paragrafi 2, shkronja b) dhe c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Ndarjet Buxhetore neni 15 pika 11 dhe 12 dhe neni 16 pika 11 i Ligjit Nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, neni 30 i ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, dispozitave të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr.05.L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, kërkesa Sh.06.Nr.9736 e datës 24.04.2025 të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit për Transfer dhe Rialokim, neni 38 paragrafi 1, të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë:30.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR RIALOKIME DHE TRANSFERE

1. Miratohet vendimi për Rialokime dhe transfer nga kategoria e shpenzimeve kapitale për vitin 2025.
2. Mjetet për transfer dhe rialokim në pikën (1) një të këtij akt vendimi do të shpërndahen:

1. Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 10

1.1 Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 10 nënprogrami Infrastruktura Publike 18189 shuma prej 8,000.00€

Nga Projektet ekzistuese :

- Ndërtimi i ashensorëve në ndërtesa Publike -Kamenicë, kodi i projektit 52386, shuma prej 8,000.00 €

Në Projektet ekzistues :

- Ndërtimi i Kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatra (Shipashnice,Karaqeve,Berivojce,Busavate,Hodonoc,Koretin,Topanice faza 2,kodi I projektit 56385, shuma prej 8,000.00

1.2 Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 10 nënprogrami Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik 48029 shuma prej 1,545.19

Nga Projektet ekzistuese :

- Ndërtimi i tregut të gjelbër në Kamenicë, kodi i projektit 52786 ,shuma prej 1,545.19

Në Projektet ekzistues :

- Ndërtimi i qendrave për Viewpoint-Busavate,Kranidell,Kike, kodi i projektit 56423,shuma prej 1,545.19 €.

1.3 Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 10 nënprogrami Planifikimi Mjedisor dhe Inspekcioni 66650 shuma prej 25,000.00 €

Nga Projektet ekzistuese :

- Asfaltimet e rrugëve të rendit 2 dhe 3 në Novoselle-Faza 1 kodi i projektit 56395 shuma prej 15,000.00 €.
- Asfaltimet e rrugëve të rendit 2 dhe 3 në Srezoc dhe Krileve-Faza 2 kodi i projektit 56400 ,shuma prej 10,000.00 €.

Në Projektet ekzistues :

- Asfaltimi i rrugëve të rendit 2 dhe 3 në Koretin - faza 2 kodi i projektit 56405 shuma prej 25,0000.00 €.

2. Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 21

2.1 Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 21 nënprogrami Administrata /16329/ shuma prej 20,000.00€

Nga Projektet ekzistuese :

- Dixhitalizimi i arkivit komunal në Komunën e Kamenicës kod i projektit 55070, shuma prej 20,000.00€

Në Projektet ekzistues :

- Ndërtimi i hapësirës në shtëpinë e kulturës "Isa Kastrati "dhe adaptimi sallës së kuvendit komunal në Kamenice, kod i projektit 54771, shuma prej 20,000.00€

2.2 Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 21 nënprogrami Infrastruktura Publike 18189 shuma prej 30,000.00€

Nga Projektet ekzistuese :

- Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra Karaqeve, Rogane, Kopernicë, Koretin, Hogosht, Hodonoc, Strezoc, Krileve, Ajnoc, Berivojce, Topanicë, Novosellë ,kod i projektit 55073, shuma prej 10.000.00
- Ndërtimi i ashensorëve në ndërtesa Publike -Kamenice , kod i projektit 56386,shuma prej 20,000.00 €.

Në Projektet ekzistues :

- Ndërtimi i pritorëve të autobusve në Hogosht , Shipashnice e Poshtme, Hodonoc, Topanicë, Koretin, kod i projektit 52735,shuma prej 10,000.00 €
- Ndërtimi i Kanalizimit fekal në Kamenice dhe fshatra (Shipashnicë, Karaqevë, Berivojë, Busavatë, Hodonoc, Koretin, Topanicë faza 2 kod i projektit 56385, shuma prej 20,000.00 €.

2.3 Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 21 nënprogrami Planifikimi Urban dhe Inspekcioni 66450 shuma prej 23,470.00€

Nga Projekti ekzistues

- Ndërtimi urave te vogla betoni ,zgjerimi dhe riparimi i urave ekzistuese në Rogane , Kamenicë, Koretin, Berivojcë, Krilevë, Kopernicë, kodi i projektit 55074, shuma prej 23,470.00€

Në Projektin ekzistues

- Ndërtimi i urave metalike /beton për këmbësorë në Koretin, Hajnoc, Berivojce, Karaqeve) kodi i projektit ekzistues 55078 në shumë prej 23,470.00€

2.4 Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 21 nënprogrami Planifikimi Mjedisor dhe Inspekcioni 66650 shuma prej 40,000.00€

Nga Projekti ekzistues

- “Ndërtim i trotuareve në Kamenicë dhe fshatra (Kopernicë, Karaqevë, Rogane, Hogosht faza 2), kodi i projektit 56407 shuma prej 40,000.00

Në Projektet ekzistues

- Ndërtim i trotuareve në Kamenicë dhe Fshatra (Topanicë, Kopernicë, Karaqevë, Shipashnicë, Rogane, Kamenicë, Koretin, kodi i projektit 56406, shuma prej 11,000.00
- Asfaltimi i rrugëve të rendit 2 dhe 3 në Koretin - faza 2 kodi i projektit 56405, shuma prej 29,000.00 €

2.5 Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 21 nënprogrami Administrata 92145 shuma prej 50,000.00€

Nga Projektet Ekzistues

- Instalimi i sistemit te ngrohjes qendrore ne IA Kamenice kodi i projektit 56420 shuma prej 30,000.00

- Ndërtimi i rrethojës për kampusin e shkollave të mesme dhe IA në Kamenicë, kodi i projektit 56421, shuma prej 20,000.00

Ne projektet Ekzistuese

- Renovimi i objekteve shkollore në Kamenicë dhe Roganë (Gjimnazet, teknikat, sh. fillore dhe çerdhja në Kamenicë, Topanicë dhe Karaqevë, kodi i projektit 55077 në shumë prej 50,000.00 €

2.6 Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 21 nënprogrami Sherbimet Kulturore 85029 shuma prej 10,000.00€

Nga Projekti Ekzistues

- Ndërtimi i galerisë së qytetit Kamenicë kodi i projektit 56416, shuma prej 10,000.00€

Ne projekti Ekzistuese

- Ndërtimi i zhveshtorëve tek stadiumi "Besa dhe Bashkimi" Shipashnice e Epërme dhe Koretin, kodi i projektit 56415, shuma prej 10,000.00 €

3. Në transfer të mjeteve nga kategoria e Rezervave në kategori të shpenzimeve kapitale

Nga

- Nga kategoria e Rezervave nënprogrami Bujqësia /47029/ shuma prej 20,000.00€

Ne Projektet:

- Asfaltimet e rrugëve të rendit 2 dhe 3 në Koretin - Faza 2 kodi i projektit 5640, shuma prej 5,000.00
- Asfaltimi i rrugëve në Kopernicë (Degz, Dëshmorët e Kombit, Syle Ademi, Degz Rruges Lelenci, Degz Ismet Asllani) kodi i projektit 56383 shuma prej 15,000.00 €

A r s y e t i m

- Kërkesa për ri-alokim të mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale kërkohet të bëhet nga ana e Kuvendit Komunal të Komunës së Kamenicës për arsye se në

projektet ku merren mjetet për rialokim janë projekte të cilat nuk janë iniciuar aktivitetet e prokurimit .

- Implikimet buxhetore nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, komunës iu është imponuar të anulohet disa nga projektet dhe të orientohet në projekte me kontrata aktive .
- Memorandum i Mirëkuptimit për financim të projekteve infrastrukturore të datës 01.04.2025 të nënshkruara në mes Ministris të Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Kryetarit të Komunës së Kamenicës.

Ndarja buxhetore në nivel të kategorisë së Rezervave të papraparë në Ligjin vjetor të buxhetit për vitin 2025 dhe në bazë të Nenit 16 Ndryshimet në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën programeve. Pika 1.1 Komuna ka vendosur që shumën prej 20,000.00€ të transferohen në shpenzime kapitale dhe atë në projektet ekzistuese për të përmbushur kontratat aktuale nga viti 2024 me operator ekonomik :

- Asfaltimi i rrugëve të rendit 2 dhe 3 në Koretin -faza 2 kodi i projektit 56405, shuma prej 5,000.00
 - Asfaltimi i rrugëve në Kopernicë (Degz, Dëshmoret e Kombit, Syle Ademi, Degz Ruges Lelenci, Degz Ismet Asllani) kodi i projektit 56383 shuma prej 15,000.00 €
 -
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
 4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7-ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.
 5. Akt Vendimit i bashkëngjitet: Kërkesa Sh.06.Nr.9736 e datës 24.04.2025 të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit për Transfer dhe Rialokim.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës për përkthime, Drejtorisë së Buxhet dhe Financa, MAPL-së dhe QSHQ - Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Liridon Kastrati